



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 347/25 Dt. 11.06.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të Rregullores (QRK) nr. 06/2023 për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për lejimin e udhëtimit zyrtar

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i Kujtim Gashit, nënkryetar i Komunës së Prizrenit dhe Nehat Elshanit, shef i Kabinetit në Zyrën e Kryetarit të Komunës së Prizrenit, për në ShBA, shtetin Iowa të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me qëllim të vizitës së këtij shteti dhe thellimit të bashkëpunimit në fusha të ndryshme mes Komunës së Prizrenit të Republikës së Kosovës dhe Qytetit Cuncil Bluffs, Pottawattamie County, Iowa, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.
2. Kjo vizitë zyrtare realizohet në kuadër të vendimit të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Prizrenit, të datës 17.10.2022, që ka të bëjë me miratimin e nismës së kryetarit të Komunës për të hyrë në bashkëpunim komunal ndërkombëtar (binjakëzim), me komunën e lartcekur dhe të marrëveshjeve tjera zyrtare rreth këtij bashkëpunimi.
3. Nisja (shkuarja) zyrtare do të bëhet me datën, 21.07.2025 dhe kthimi me 28.07.2025, kështu që, për këtë qëllim lejohen mjetet e nevojshme për: mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit, ushqimit, akomodimit, pagesa e mëditjeve, si dhe për shpenzime të paparashikuara, për të lartcekurit.
4. Shuma e lejuar, e përshkruar si në këtë Vendim, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Zyrës së Kryetarit dhe Komunës së Prizrenit.
5. Obligohet Kabineti i Kryetarit të Komunës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Të lartcekurve,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

